



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Prilaz / Predaja Receipt / Delivery	15. 03	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jednica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHOK	1391/2022		1/4	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.133/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar - Malore Gashi - Bajraktari, Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 772/2021, të datës 27.08.2021, të ankuesit [redacted] me adrese banimi Rruga [redacted] Komuna e Prishtinës, ka shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.Nr.2691/2021, të datës 09.02.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 772/2021 e datës 27.08.2021, e parashtruar nga ankuesi [redacted] sipas Aktgjykimit A.Nr.2691/2021 të datës 09.02.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative.
- II. MBETET NË FUQI, Vendimi i datës 29.07.2021 me numër protokoll 6619 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Sipas shkresave të lëndës ankuesi [redacted] i punësuar në kuadër të Ministrisë së Ambientit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 27.08.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet

ankimore, lidhur me transferimin/sistemimin e përkohshëm në pozitën Koordinator për të Drejtat e Njeriut sipas vendimit të datës 29.07.2021 me numër protokoll 6619 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.10.2021, me shkresën me numër protokoll 4995/2021, ka njoftuar ankuesin [redacted] se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr.772/2021, të datës 27.08.2021, për shkak se Këshilli nuk ka kuorum për vendosje, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me njoftimin e datës 07.10.2021, të KPMSHCK-së, ka hapur konfliktin administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 09.02.2021, ka nxjerr Aktgjykim me nr. A.Nr.2691/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 07.10.2021, dhe ka obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 772/2021, të datës 27.08.2021, të ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.08.2021, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 4417/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa a. Nr. 133/2022 e datës 14.02.2021, sipas Aktgjykimit A.Nr.2691/2021 të datës 09.02.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 07.10.2021, me numër protokoll 4953/2021, i Këshillit; Vendimi i datës 29.07.2021, me numër protokoll 6619, i Sekretariatit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Akt Emërimi i datës 11.06.2019, i ankuesit [redacted] Vendimi A. Nr. 225/2021 i datës 05.05.2021, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës 09.02.2021, A.Nr. 2691/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, [redacted] duke e anuluar njoftimin e datës 07.10.2020, të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 772/2021, të datës 27.08.2021, të ankuesit

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës duke peshuar me kujdes të gjitha provat veç e veç dhe së bashku në tersi, ka konstatuar se Vendimi i KPMSHCK Anr.225/2021 i datës 05.05.2022, është marr pasi ankuesja [redacted] Udhëheqëse e Divizionit të Auto shkollave në Departamentin e Automjeteve, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK-së kundër Vendimit

të KZKA-së nr.5613 të datës 24.05.2019 (Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave), sepse ky vendim i KZKA kishte lënë në fuqi vendimin kundërligjor të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës me nr. 5613 të datës 24.05.2019. (tash Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)

Kolegji me qëllim të shterimit të gjitha argumenteve juridike ka bërë një kronologji të rastit, me datë: 18.07.2017 Ministria e Infrastrukturës (tash Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) ka shpallur konkurs për avancim me referencë RN00002107 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auto shkollave, komisioni rekrutues me datë: 04.08.2017 ka përpiluar raportin përfundimtar sipas të cilit kandidaten \_\_\_\_\_ e ka rekomanduar për këtë pozitë, tutje procedurat deri në lëshimin e akt emërimit janë bërë në harmoni me ligjet në fuqi. Më datë 24.08.2017 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Raportin nr.147/2017 kishte miratuar këtë procedurë si të rregullt. Më datë 24.05.2019 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës (tash Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) nxjerr Vendim me nr.5613 me të cilin e ANULON të gjitha veprimet që kane rrjedh nga konkursi për avancim me referencë RN00002107, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Auto shkolla.

Nisur nga konstatimet e më sipërme, pas mbetjes së pozitës Udhëheqës i Divizionit të Auto shkollave e zbratur, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës (tash Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Kryeshefi i Agjencisë Pyjore të Kosovës me datë 11.06.2019 nënshkruaj Memorandum të Mirëkuptimit me të cilin ankuesin \_\_\_\_\_ nga pozita e Udhëheqësit të Sektorit të Teknologjisë Informative dhe Logjistike gjegjësisht nga koeficienti 8 sa ankuesi e ka pasur në Agjencinë e Pyjeve e transferojnë në mënyrë të përhershme në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Atu shkollave gjegjësisht në koeficientin 9.

Kolegji konstaton se memorandum i lartshënuar është i kundërligjshëm, sepse ankuesin e ka ngritur në pozitën e punës nga koeficienti 8 në koeficienti 9 në kundërshtim me dispozitat ligjore me Nenin 27, paragrafin 1 nën paragrafi 1.1,1.2.1.3,1.4, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se; 1. **Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale, si dhe në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë.**

Kolegji, konstaton se siç është përkthyer më lartë, është anuluar konkurs i datës 18.07.2017 me referencë RN00002107 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auto shkollave, që KPMSHCK me vendimin Anr.225/2021 ka konstatuar se anulimi i konkursit dhe të gjitha procedurave që rrjedhin nga ky konkurs është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në

fuqi nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës (tash Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe pas anulimit të konkursit të lartpërmendur kjo pozitë është plotësuar përmes të një memorandumi të kundërligjshëm, prandaj Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka vepruar drejtë kur ka bërë zbatimin e Vendimit të KPM SHCK-së nr. Anr.225/2021 dhe në të njëjtën kohë konstaton nga ajo që u tha më lartë se pretendimet e ankuesit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, sepse ankuesi ka mbajtur atë pozitë përmes një memorandumi të kundërligjshëm siç është sqaruar në paragrafët e më sipërm...

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

*Lënda Nr. A. Nr.133/2022*

*Rushit Kajtazi*

*Procesmbajtës*

*Eshref SHABANI*

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Gjyqtarit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI;
- Udhëheqësit të Personelit në MMPHI;
- Arkivit të KPM SHCK-së

